



THE WORLD BANK

IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Operations Policy & Country Services

Investimet në infrastrukturë dhe menaxhimi i aktiveve të qëndrueshme

21 nëntor 2019

Svetlana Klimenko

Krye-Specialiste për Drejtimin Financiar

INVESTIME NË INFRASTRUKTURË TË QËNDRUESHME

- Investimet në infrastrukturë janë kyç për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Boshllëku global i investimeve në infrastrukturë çmohet se është me trilionë dollarë.
- I vetëm, sektori publik nuk mund ta mbushë këtë boshllëk. Thelbësor është kontributi i sektorit privat.
- Aftësia e qeverisë për ta menaxhuar në mënyrë efektive bilancin e saj, përfshirë edhe aktivet e qëndrueshme, jo vetëm që ndihmon në planifikimin e investimeve të sektorit publik në infrastrukturë, por ndihmon edhe dialogun me sektorin privat dhe në menaxhimin e risqeve të perceptuara dhe reale.
- Qëndrueshmëria në kohë është kthyer në tipar i spikatur i strategjive për investimet infrastrukturore. Është trajtuar nëpërmjet një sërë forumesh të nivelit të lartë, përfshirë edhe Grupin G20 (Parimet e Grupit G20 për Investime Cilësore Infrastrukturore).

https://www.mof.go.jp/english/international_policy/convention/g20/annex6_1.pdf

- Infrastruktura e qëndrueshme është komplekse, me natyrë afatgjatë, dhe shoqërohet nga risqe të shumta dhe një numër i madh palësh interesi. Kjo e ndërlikon rolin e vendimmarrësve të politikave dhe të profesionistëve, të cilët duhet t'u përgjigjen pritjeve dhe objektivave të shumta në një mjedis tejet dinamik.

INFRASTRUKTURA E QËNDRUESHME

NJË SFIDË KOMPLEKSE QË KËRKON NJË KUNDËRPËRGJIGJE TË BASHKËRENDUAR DHE SHUMËDISIPLINORE



Projekti horizontal i OECD-së “Politikat strategjike për një infrastrukturë të qëndrueshme”

- Infrastruktura e qëndrueshme kërkon bashkëpunim të shtatë temave kryesore;
- Mes tyre, përgatitja e instrumenteve të qeverisjes dhe vendimmarrjes është thelbësore për realizimin e infrastrukturave me kosto efektive, me nivel të ulët të gazit karbonik, gjithëpërfshirëse dhe inteligjente.

INVESTIMET NË INFRASTRUKTURË DHE MENAXHIMI I AKTIVEVE TË QËNDRUESHME

- Aktivitetet e qëndrueshme përbëjnë një pjesë kyçe të bilancit shtetëror, e cila është thelbësore për vendimmarrjen dhe menaxhimin e investimeve në infrastrukturë;
- Cilësia e informacioneve të gatshme mund të sjellë kursime (ose humbje) të ndjeshme të burimeve publike;
- Rregullat kontabël mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimet ekonomike (PPP);
- Në mënyrë ideale, departamenti i ngarkuar me menaxhimin e aktiveve të qëndrueshme do të duhej të punonte në bashkëpunim të ngushtë me drejtoritë që bëjnë planifikimin dhe financimin e investimeve;
- Një pjesë e sfidës në lidhje me bashkëpunimin midis sektorit privat dhe atij publik është se flasin “gjuhë të ndryshme”, përfshirë edhe gjuhën kontabël (bazë me të drejta dhe detyrime të konstatuara, nga njëra anë, dhe bazë e modifikuar me të drejta dhe detyrime të konstatuara, nga ana tjetër). Kjo mund të çojë në keqkuptime/keqvlërësime të risqeve dhe mundësive ekzistuese.

GJENDJA E TANISHME E MENAXHIMIT, KONTROLLIT DHE KONTABILIZIMIT TË AKTIVEVE TË QËNDRUESHME

(NË BAZË TË STUDIMIT RAJONAL TË BANKËS BOTËRORE PËR AMERIKËN LATINE, 2017)

- **Kontabiliteti dhe menaxhimi i aktiveve, përfshirë identifikimin, njohjen dhe matjen, nuk është parë si çështje me përparësi nga shumica e qeverive në rajon, pavarësisht nga ndikimi i ndjeshëm në qëndrueshmërinë e politikave buxhetore dhe financave publike në vend.**
- **Ngaqë raportet financiare shtetërore shpesh nuk pasqyrojnë në mënyrë të arsyeshme informacion për të gjitha aktivet e qëndrueshme të sektorit publik, qeveritë e kanë të pamundur të kenë një pamje objektive të pozicionit financiar dhe performancës financiare. Kjo cenon mundësinë për të menaxhuar me efektivitet burimet burime, në përputhje me angazhimet zgjedhore.**
- **Mungesa apo paplotësia e informacionit mbi aktivet e qëndrueshme dhe, në veçanti, mbi projektet infrastrukturore të sektorit publik, dhe e parashikimeve për mirëmbajtjen apo zëvendësimin, shkakton vështirësinë e rajonit sa i takon përmirësimin të infrastrukturës publike dhe politikave të investimit dhe nxitjes së rritjes së produktivitetit dhe aftësisë konkurruese në nivel kombëtar dhe rajonal.**

SFIDAT E ZAKONSHME NË MENAXHIMIN E AKTIVEVE TË QËNDRUESHME

- Kuadër i vjetruar ligjor dhe rregullator në këto fusha:
 - Kontabiliteti i sektorit publik;
 - Menaxhimi, kontrolli dhe kontabilizimin i aktiveve të qëndrueshme;
 - Auditimi dhe mbikëqyrja; dhe
 - Transparenca dhe mundësia e shikimit të informacioneve financiare shtetërore.
 - Mbivendosja e përgjegjësive dhe mungesa e komunikimit dhe bashkërendimit mes funksioneve shtetërore rregullatore dhe operative që kanë të bëjnë me menaxhimin, kontrollin dhe regjistrimin e aktiveve të qëndrueshme.
 - Mungesa e sistemeve të kompjuterizuara dhe të integruara të menaxhimit financiar, çka çon në një numër të madh regjistrash me mbivendosje dhe e ndërlikon konsolidimin e informacioneve financiare dhe administrative.



SFIDAT E ZAKONSHME NË MENAXHIMIN E AKTIVEVE TË QËNDRUESHME

- Informacione jo të besueshme dhe të vjetruara financiare të cilat nuk mund të përdoren për vendimmarrjen.
- Mungesë verifikimi, rakordimi dhe vlerësimi periodik të kategorive të ndryshme të aktiveve të qëndrueshme.
- Sistem i dobët i kontrollit të brendshëm dhe i mbikëqyrjes së jashtme për menaxhimin e aktiveve të qëndrueshme, sidomos në nivel të qeverisjes nën nivelin qendror. Sistemi ekzistues i kontrollit të brendshëm fokusohet më shumë te përputhshmëria ligjore se sa te efikasiteti i menaxhimit të investimeve publike.
- Mungesë e strategjive të përcaktuara qartë për të orientuar zbatimin e reformave të menaxhimit të aktiveve dhe kontabilitetit në sektorin publik, dhe vëmendje e pamjaftueshme për procesin e menaxhimit të ndryshimit, përfshirë hartimin dhe zbatimin e planeve të komunikimit dhe trajnimit.

ÇËSHTJE QË DUHEN MBAJTUR PARASYSH: SISTEMI POLITIK DHE KUADRI LIGJOR

- Sistemi politik i vendit, federal apo unitar, dhe shkalla e centralizimit apo decentralizimit ndikon në kontabilizimin e aktiveve afatgjata materiale në shumë mënyra, si: përcaktimi i bazës autoritative për të përdorur standardet dhe hartuar politikat dhe procedurat e lidhura; përcaktimi se cilat njësi ekonomike do të kenë në kujdestari aktivet dhe do t'i njohin në pasqyrat e tyre financiare; përgjegjësia për krijimin dhe mbajtjen e regjistrave të aktiveve; dhe kërkesat për të përfshirë aktivet afatgjata materiale në pasqyrat e konsoliduara financiare;
- Në sistemet politike federale, njësitë qendrore dhe nënqendrore të qeverisjes zakonisht kanë ligje të pavarura, përfshirë edhe kërkesat për raportimin financiar, dhe nuk ndodh rrallë të gesh standarde të ndryshme kontabiliteti midis qeverisjes qendrore dhe njërive të qeverisjes nën nivelin qendror. Nga ana tjetër, në sistemet unitare ka një autoritet të vetëm qendror që dominon mbi qeverisjen qendrore dhe vendore, me shkallë të ndryshme të delegimit të kompetencave.
- Kërkesat aktuale legjislative dhe lehtësia me të cilën mund të bëhen ndryshime, nëse del nevoja, kanë ndikim të ndjeshëm në kompleksitetin dhe momentin e zbatimit të SNKSP 17 pas miratimit për zbatim. Tri fusha kyçe që varen nga karakteristikat e kuadrit ligjor janë i. përcaktimi i të drejtave për kontroll dhe të drejtave për përfitime ekonomike ose potencial shërbimi në të ardhmen nga AAM-ja, ii. vendosja e bazës legjislative për politikat kontabël dhe procedurat e kontabilizimit të AAM-ve dhe iii. ndryshimi i planit kontabël (PK) për të mundësuar kategorizimin dhe klasifikimin e saktë të aktiveve dhe futjen e informacioneve sipas të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në lidhje me njohjen dhe matjen e AAM-ve.

ÇËSHTJE QË DUHEN MBAJTUR PARASYSH: KLASIFIKIMI

Aktivet infrastrukturore të sektorit publike, sipas kategorive

Transporti dhe shërbimet komunale

- Rrugët
- Hekurudhat
- Portet
- Energjia elektrike
- Gazi
- Uji
- Ujërat e përdorura
- Komunikacioni

Infrastruktura sociale

- Shkollat, kolegjet, universitetet dhe institucionet kërkimore
- Spitalet
- Varrezat

Infrastruktura e qeverisjes

- Ndërtesa e parlamentit dhe ndërtesat e qeverisë
- Gjykatat
- Burgjet dhe institucionet e vuajtjes së dënimit
- Shërbimet e urgjencës (zjarrfikësit, policia, ambulanca)
- Bazat ushtarake, postëkomandat, depot e municioneve dhe poligonet e qitjes

Infrastruktura kulturore, sportive dhe argëtuese

- Bibliotekat
- Muzeumet
- Qendrat e arteve dhe kulturës
- Kopshtet botanike
- Parqet dhe lulishtet komunale
- Parqet kombëtare dhe zonat e mbrojtura

ÇËSHTJE QË DUHEN MBAJTUR PARASYSH: BURIMET E TË DHËNAVE PËR MATJEN NË FILLIM

Aktivet infrastrukturore	Pronat e paluajtshme
<ul style="list-style-type: none">▪ Skicat inxhinierike▪ Intervista me individë të pranishëm gjatë periudhës së ndërtimit:<ul style="list-style-type: none">○ Operatorë○ Administratorë○ Pronarë▪ Intervista me banorë▪ Vrojtime me sy të lirë▪ Përlllogaritje e aktiveve të nëntokës bazuar në krahasime me rajone të tjera të vendit ose me vendet fqinje▪ Kontrata▪ Buxheti▪ Fondet e miratuara	<ul style="list-style-type: none">▪ Regjistri i pasurive të paluajtshme▪ Kartelat tatimore<ul style="list-style-type: none">○ Shitblerjet e pronave○ Vlerësimet periodike tatimore▪ Intervista me individë të pranishëm gjatë periudhës së ndërtimit:<ul style="list-style-type: none">○ Operatorë○ Administratorë○ Pronarë▪ Kontrata

ÇFARË MUND TË BËHET

- **Kuadri ligjor dhe rregullator.** Me fillimin e reformave të sektorit publik nga ana e qeverive, për modernizimin e kontabilitetit, menaxhimit dhe kontrollit të aktiveve të qëndrueshme, duhen shqyrtuar dhe përditësuar edhe kornizat ligjore dhe rregullatore, për të pasqyruar standardet, proceset dhe përgjegjësitë e reja organizative. Kjo mund të kërkojë miratimin e një ligji të ri ose përdorimin/përshtatjen e standardeve ndërkombëtare/praktikave më të mira, si SNKSP, Komiteti i Organizatave Sponsorizuese të Komisionit “Treadway”, Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve të Kontrollit të Lartë (ISSAI) etj. Mund të kërkojë edhe rishikimin e ligjeve të transparencës, për të siguruar të drejtën për informim të qytetarëve në lidhje me informacionet financiare shtetërore.
- ***Struktura organizative.*** Duhet shqyrtuar dhe sqaruar rolet dhe përgjegjësitë e njësive të ndryshme të rregullatore dhe operative të përfshira në menaxhimin, kontabilitetin dhe kontrollin e aktiveve të qëndrueshme në bazë të strukturës së përditësuar ligjore dhe organizative. Krijimi i një komiteti drejtues, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve përkatëse të sektorit publik përgjegjëse për mbikëqyrjen e reformave me fokus te aktivet e qëndrueshme, ndihmon në arritjen e rezultateve më të mira dhe përmirëson komunikimin dhe bashkërendimin mes palëve të ndryshme të interesit të përfshira në këtë proces.
- ***Sistemet e informacionit.*** Sistemi i Integruar i Informacionit të Menaxhimit Financiar (IFMIS) mund të ketë nevojë për përditësim/përshtatje për të integruar në strukturën e tij menaxhimin dhe kontrollin e aktiveve të qëndrueshme.

ÇFARË MUND TË BËHET

- **Menaxhimi dhe kontrolli i aktiveve të qëndrueshme.** Sa më poshtë mund të ndihmojnë në përmirësimin e kontrollit dhe menaxhimit të efektiv të aktiveve të qëndrueshme: i. inventarizim, klasifikim dhe verifikim periodik i inventarëve fizikë; ii. vlerësim fillestar dhe i mëpasshëm i aktiveve (përfshirë amortizimin dhe zhvlerësimin); iii. rakordim i tepricave kontabël të aktiveve të qëndrueshme dhe regjistrave të aktiveve; dhe v. hartim i planeve të mirëmbajtjes dhe zëvendësimit për aktivet e qëndrueshme me rëndësi strategjike (p.sh., infrastruktura publike). Audituesit e brendshëm dhe të jashtëm duhet të marrin pjesë aktive në këtë proces, në bashkëpunim me njësitë e tjera të qeverisjes.
- **Llogaridhënia dhe transparencja.** Menaxhimi efikas i investimeve publike ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve që qeveritë u ofrojnë qytetarëve dhe në aftësinë e qytetarëve për t'u kërkuar llogari qeverive. Kjo llogaridhënie mund të arrihet nëpërmjet i. auditimeve financiare periodike më cilësore; ii. forcimit të bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes njërive përgjegjëse për kontrollin e brendshëm dhe mbikëqyrjen e jashtme; dhe iii. bërjes publike të pasqyrave financiare të audituara dhe informacioneve të tjera.
- **Menaxhim i ndryshimit.** Menaxhimi i ndryshimit është pjesë e rëndësishme e strategjisë së qeverive në mbështetje të zbatimit të reformave për aktivet e qëndrueshme. Ajo, ndër të tjera, duhet të fokusohet në këto çështje: i. objektivat dhe objekti i reformave dhe metodika e zbatimit; ii. kampionët kyç dhe përbërja e ekipit që është përgjegjës për zbatimin e projektit; iii. planet komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm, përfshirë fushatat e informimit dhe ndërgjegjësimit; iv. një plan të gjithanshëm trajnimi dhe ngritjesh të kapaciteteve; dhe vi. mekanizmat e marrjes së reagimit.

PËRFSHIRJA E ASPEKTEVE TË QËNDRUESHMËRISË DHE PËRMIRËSIMI I BASHKËPUNIMIT ME SEKTORIN PRIVAT

- Qëndrueshmëria në kohë kërkon ndërthurjen e objektivave ekonomikë, mjedisorë, shoqërorë, qeverisës, financiar dhe zhvillimorë në planifikimin, zbatimin dhe menaxhimin e infrastrukturës.
- Kërkon qasje komplekse dhe shumëdispline.
- Njihet si prioritet kyç nga qeveritë, rregullatorët, organet shtetërore dhe sektori privat.
- Një sërë sfidash komplekse që duhet të marrin zgjidhje, përfshirë kontabilitetin; pra, si të shprehet në vlera monetare efekti pozitiv dhe negativ.
- Sektori privat kërkon mundësi për të punuar me qeverinë dhe organizatat ndërkombëtare për t'i rritur investimet e qëndrueshme afatgjata në mbështetje të zbatimit të OZHQ-ve, përfshirë edhe infrastrukturën.
- Funkzioni që kanë të dhënat në tregje. Cilësia e mirë e të dhënave shtetërore, përfshirë të dhënat mbi aktivet e qëndrueshme i japin mundësi sektorit privat të përfshihet.
- Investitorët u bëjnë thirrje qeverive të shfrytëzojnë fuqinë e bilanceve (krahas mundësimit të reformave të politikave) për të menaxhuar më mirë risqet e perceptuara dhe reale.